L I G J
Nr. 8923, datë 22.7.2002

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS FINANCIARE NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE MEDIOCREDITO CENTRALE, ITALI, PËR FINANCIMIN E IMPORTIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Konventa financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale, Itali, për financimin e importit të energjisë elektrike".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3422, datë 7.8.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

KONVENTË
FINANCIARE NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE MEDIOCREDITO CENTRALE, INSTITUTI QENDROR PËR KREDINË AFATMESME S.P.A.

Në përputhje me nenin 6 të ligjit nr. 49, datë 26.2.1987 të Republikës Italiane ndërmjet:

- Qeverisë së Republikës të Shqipërisë (që tani e tutje i quajtur Huamarrësi), duke vepruar nëpërmjet Ministrisë së Financave, përfaqësuar nga Ministri i Financave z. Kastriot Islami, nga njëra anë; dhe

- Mediocredito Centrale S.P.S., (MCC) një Kompanie të Përbashkët Stoku i Grupit Bankar të Bankaromës, një grup listash të regjistruara në Grupin Bankaromë aksione 950, 277, 270 Lit, me zyrë të regjistruar në Romë, Rruga "Piemonti 51", regjistruar në regjistrin e Kompanisë në nr. 3362/94, VAT, Nr. 00915101000, me kodin taksor nr. 00594040586 (që tani e tutje e quajtur Mediocredito Centrale) si administratore e fondit të krijuar me nenin 6 të ligjit italian nr.49 të 26 shkurtit 1987, përfaqësuar nga z. Giulio Pascalio dhe z. Francesco Anania nga ana tjetër;

Meqenëse:

a) Bazuar në Memorandumin e mirëkuptimit nënshkruar në 17.4.2002 midis Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë, së fundi angazhohet vetë për t'i dhënë Qeverisë së Republikës të Shqipërisë një kredi financiare për maksimumin e shumës në euro 30, 000, 000 (tridhjetë milion) për financimin e importit të energjisë elektrike nga Italia për të përballuar krizën energjetike prezente në Shqipëri.

b) Ministria e Thesarit të Qeverisë së Republikës të Italisë, me propozim të Ministrit të Punëve të Jashtme, me dekret nr. 407320, datë 13.5.2002, ka autorizuar Mediocredito Centralen të japë një kredi financiare për euro 30, 000, 000 (tridhjetë milion) për Republikën e Shqipërisë, me kushtet e mëposhtme:

- shlyerja: me 42 (dyzetë e dy) këste principale të barabarta 6-mujore, ku e para do të skadojë 210 (dyqind e dhjetë) muaj pas datës së bërjes efektive të Konventës Financiare.

- norma e interesit: interesi vjetor nominal 0.2% (zero pikë njëzet për qind) pagueshëm në fundin e çdo periudhe 6-mujore nga data e secilit disbursim;

- qëllimi i kredisë: financimi i importit të energjisë nga Italia për përballimin e krizës energjetike prezente në Shqipëri.

Tani dhe për këto arsye:

Duke e konsideruar edhe hyrjen, si një pjesë përbërëse të kësaj Konvente, së bashku me anekset përkatëse, Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Përkufizimi

Në Konventën Financiare dhe në anekset, për më tepër, në termat që do të pasojnë:

- "Deklarata e Borxhit" është deklarata e cilësuar në nenin 8, në të cilën Huamarrësi merr detyrimin karshi Mediocredito Centrales për të shlyer kuotat kapital dhe interesat e kësaj kredie finaciare.

- "Kompani Audituese" është një staf i kualifikuar e përfshirë në një kompani audituese me eksperiencë ndërkombëtare. Kompania Audituese përcaktohet në nenin 4, e cila do të ketë funksionin për auditimin e dokumenteve administrative, procedurave të prokurimeve për implementimin e programit.

- "Kontrata Tregtare" është kontrata e furnizimit ose kontratat e furnizimit, në përputhje me blerjen e energjisë nga Italia në lidhje me realizimin e programit.

- "Dokumentacioni Kontraktual" është dokumentacioni i parashikuar në Kontratën Tregtare dhe që përfshin mënyrat e pagesës, (p.sh. faturat, packing list/gjendjen e ecurisë).

- "Konventa Financiare" është kjo Konventë Financiare, hyrja së bashku me anekset, të cilat janë pjesë përbërëse të saj.

"Kredi Financiare" është financimi që Mediocredito Centrale, në bazë të autorizimit të dhënë nga Ministria e Thesarit, me propozim të Ministrisë së Punëve të Jashtme, jep sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në hyrje dhe në nenin 2 të kësaj Konvente.

- "Periudha e qetësisë" është periudha e cila fillon nga data e hyrjes të kësaj Konvente në fuqi dhe përfundon 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet nga kjo datë, siç përshkruhet në hyrje të Konventës.

- "Autoritetet Kompetente Italiane" janë Ministria e Thesarit dhe/ose Ministria e Punëve të Jashtme (organi kompetent i Kooperacionit, Drejtoria e Përgjithshme për kooperim dhe zhvillim, Komiteti Drejtues) dhe/ose ente të tjera italiane që i parashikon ligji.

- "Programi" është plani i blerjes së energjisë elektrike nga Italia, i zbatuar nga Qeveria Shqiptare.

- "Llogaria Speciale" është llogaria speciale e hapur me Bankën e Shqipërisë, në të cilën do të kreditohen 30.000.000 euro, sipas nenit 6.

Neni 2
Kredia Financiare

2.1. Mediocredito Centrale i jep Huamarrësit dhe Huamarrësi pranon një kredi financiare deri në shumën maksimale prej euro 30,000,000 (tridhjetë milion).

2.2. Kredia në fjalë do të jetë e ndarë në dy këste, Llogaria Speciale e Kredisë do të hapet në Bankën e Shqipërisë pas ndjekjes së kohës së zhvillimit.

- Kësti i parë me një shumë totale prej euro 10,000,000 (dhjetë milion) do të disbursohet pasi Konventa Financiare të hyjë në fuqi në përputhje me proceduat sipas nenit 6 për financimin e shpenzimeve, duke filluar nga 4 prilli 2002. Ky këst do të jepet në varësi të procedurës specifike duke ndjekur në nenin 2.3.

- Kësti i dytë me një total prej euro 20,000,000 (njëzet milion) do të disbursohet në përputhje me procedurat e nenit 6, pasi të jenë përfunduar procedurat e blerjeve, siç specifikohen në nenin 2.3.

2.3. Energjia elektrike që do të blihet në Itali në përputhje me procedurat e prokurimit të kredive të Bankës Botërore dhe duke pasur parasysh specifikat e Kredisë së Ndihmës Italiane, sipas

ligjit nr. 49, datë 26.2.1987.

Shuma e 2,000,000 (dy milion) euro do të jepet në përputhje me specifikimet e procedurave në paragrafin 3.7 (e) ose paragrafin 3.5 dhe 3.6 të procedurave të prokurimit. Shuma 8,000,000 (tetë milion) euro do të jepet sipas paragrafit 3.5 dhe 3.6 të procedurave të prokurimit.

Mbetja prej 20,000,000 (njëzet milion) euro do të jetë e vlefshme në përputhje me procedurat e blerjeve sipas paragrafit 3.3 dhe 3.4 të procedurave të prokurimeve.

2.4. Kredia Financiare do të vihet në dispozicion dhe do të përdoret në përputhje me kushtet dhe afatet e shprehura në këtë Konventë, pavarësisht nga qëndrime të ndryshme të Autoriteteve Qeveritare Kompetente Italiane.

Neni 3
Efektiviteti i Konventës Financiare

3.1. Kjo Konventë do të bëhet efektive sapo Mediocredito Centrale të ketë marrë nga Huamarrësi dokumentet e mëposhtme:

(i) deklaratë nga autoritetet kompetente të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë që të vërtetojë se firmat në këtë Konventë janë ato të personave që kanë plotfuqishmëri sipas ligjeve, rregullave dhe dispozitave në fuqi në Shqipëri, për të marrë përsipër detyrimet që lindin në kuadrin e kësaj Konvente për Huamarrësin;

(ii) një dokument me shkrim nga Huamarrësi ku të caktohet personi ose personat që kanë plotfuqishmëri për të firmosur në emër të Huamarrësit Deklaratën e Borxhit, që i referohet nenit 8 (aneksi C) dhe (anekseve A dhe B). Ky dokument duhet të përcaktojë, gjithashtu, emrin dhe postin e personave në fjalë, si dhe të përmbajë specimenet e firmave të personave në fjalë.

3.2. Me marrjen e këtyre dokumenteve, njoftimeve të Huamarrësit MCC do të konfirmojë në një letër datën të cilën Konventa Financiare do të bëhet efektive.

Neni 4
Kompania Audituese

4.1. Kompania Audituese do të caktohet nga Huamarrësi me qëllimin e auditimin të dokumenteve administrative dhe procedurave të prokurimeve për zbatimin e programit.

Kompania Audituese, siç përshkruhet në nenin.6, do të përcaktojë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe MCC-në, në raporte tremujore të përfshira në dokumentet (kontrata, fatura, lajmërime, raporte prokurimesh, dokumente blerjesh etj.).

Neni 5
Afati për disbursimin e Kredisë Financiare

5.1. Afati i përdorimit të Kredisë Finanicare është 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga data e bërjes efektive të Konventës Financiare. Ky afat mund të zgjatet nga ana e Medicredito Centrales. Mediocredito Centrale nuk mund të shtyjë kohën e disbursimit vetëm në rastet kur Huamarrësi ose Autoritetet Kompetente italiane nuk janë dakord dhe kjo duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të paraqitet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbarimi i afatit.

5.2. Në fund kur periudha e disbursimeve ka mbaruar dhe nuk është zgjatur, Mediocredito Centrale, duke u konsultuar me Autoritetin Italian kompetent, i bën të ditur Huamarrësit dhe agjentit lokal për anulimin e detyrimit lidhur me fondet e papërdorura.

Neni 6
Kushtet për përdorimin e fondeve

6.1. Pasi kjo Konventë do të jetë bërë efektive, Mediocredito Centrale do të ekzekutojë kërkesat e disbursimeve në përputhje me specifikimet e mësipërme.

6.2. Kërkesa e parë për disbursim e dërguar nga Huamarrësi, në përputhje me aneksin A për shumën 10,000,000 (dhjetë milion) euro do të kreditohet pasi Mediocredito Centrale të ketë marrë dokumentet e mëposhtme:

- komunikimin nga Huamarrësi për hapjen e llogarisë speciale në Bankën e Shqipërisë ku do të kreditohen fondet;

- komunikimin nga Huamarrësit për përzgjedhjen e Kompanisë Audituese, e cila do të përzgjidhet sipas specifikimeve "no objection", të vendosura nga Ministria e Punëve të Jashtme.

6.3. Kërkesa e dytë për disbursim do t'i njoftohet Huamarrësit sipas aneksit B për shumën euro 20,000,000 (njëzet milion) do të kreditohet pasi të jetë marrë "no objection", në bazë të raportit nga Kompania Audituese, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga MCC-ja dhe Ministria e Punëve të Jashtme.

6.4. Një muaj pas derdhjes së disbursimit të transhit të parë, Kompania Audituese do të informojë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe MCC-ja me një raport të gjatë në lidhje me të gjithë dokumentacionet përkatëse (kontakte, fatura, lajmërime, raporte prokurimesh, dokumente blerjesh etj.). Ky raport do t'i referohet shumës totale të derdhur të transhit të parë të disbursuar.

6.5. Tre muaj pas derdhjes së disbursimit të transhit të dytë Kompania Audituese do të informojë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe MCC-në me një raport tremujor në lidhje me të gjithë dokumentacionet përkatëse (kontakte, fatura, lajmërime, raporte prokurimesh, dokumente blerjesh etj.). Ky raport do t'i referohet shumës totale të derdhur të transhit të dytë të disbursuar.

6.6. Pas kontrollit të mësipërm MCC-ja do të njoftojë Huamarrësin që transaksioni i shumës totale do të konsiderohet i përshtatshëm që mund të aplikohet dhe në kushte të njëjta.

6.7. Nëse do të jetë i papërshtatshëm, atëherë Huamarrësi merr përsipër t'i kreditojë Llogarisë Speciale me fondet e alokuara për këtë transaksion dhe në këto kushte të alokojë shumat e mësipërme në mënyrë të përshtatshme.

6.8. Ndjekja e çdo fondi kreditimi nga MCC-ja do t'i dërgohet me shkrim dhe skedulim për çdo shumë të disbursimeve, regjistruar sipas nenit 7. Huamarrësi do të konfirmojë me shkrim miratimin në lidhje me skedulin e pagesave.

Neni 7

Shlyerja e Kredisë Financiare dhe pagesa e interesave

7.1. Çdo shumë e kredituar në "llogarinë me jashtë" do të shlyhet sipas tabelës së shlyerjes në 42 (dyzet e dy) këste të njëpasnjëshme, të barabartë gjysmëvjetore (kështet kryesore), ku e para do të skadojë 210 muaj (dyqind e dhjetë) nga data e bërjes efektive të kësaj Konvente. Mediocredito Centrale do t'i dërgojë Huamarrësit një kopje të skedulit të pagesave në lidhje me nenin 6.7.

7.2. Në kështet e shumës principale që kanë të bëjnë me çdo kreditim në "llogarinë me jashtë", interesi do të llogaritet me një normë vjetore nominale 0.20% (zero pikë njëzet për qind), e barabartë me 0.10% (zero dhjetë) për gjysëm viti, duke u nisur nga data e kreditimit deri në datën e shlyerjes së këstit të fundit. Interesi do të jetë i llogaritur në bazë të tridhjetë ditëve mujore dhe në një vit prej treqind e gjashtëdhjetë ditësh (360/360).

7.3. Gjatë periudhës së rishlyerjes, interesi do të paguhet në të njëjtën ditë me kështet e principalit. Gjatë periudhës së faljes, interesi do të paguhet çdo gjashtë muaj në datat që korrespondojnë në ditë dhe muaj me datat e shlyerjes së kësteve të principalit. Si rrjedhojë, kësti i parë i interesit, relativisht, mund të lidhet me një periudhë më të vogël se ajo 6-mujore. Megjithatë, edhe sikur kjo periudhë të rezultonte më e vogël se 30 ditë, kësti i interesit korrespondues do të paguhej bashkë me kështin e interesit pasardhës. Kësti i parë i interesit, që ka të bëjë me një periudhë për më pak ose më shumë se gjashtë muaj, do të llogaritet për ditët aktuale midis datës së kreditimit në "llogarinë me jashtë" dhe datës së pagesës së tyre mbi bazat e një 6-mujori prej 180 ditësh.

7.4. Pagesa e interesit, e lidhur me çdo disbursim, do të bëhet në datat e treguara në tabelën e shlyerjeve, sipas nenit 6.8., deri në datën e lëshimit të Deklaratës së Borxhit, që i referohet nenit 8 më poshtë, për periudhën e mëposhtme; shlyerja e principalit dhe pagesa e interesave në datat e treguara në tabelën e shlyerjeve që i ngjitet Deklaratës së Borxhit të lartpërmendur.

7.5. Për pagesat dhe ripagesat e detyrueshme në Konventën Financiare, sa më mirë dhe nën Deklaratën e Borxhit, Huamarrësi merr përsipër vetiu shlyerjen e vonesave korresponduese të shumës në euro në datën aktuale në favor të Mediocredito Centrales ose të personave titullarë me Bankën Italiane c/o komunikuar nga MCC-ja për Huamarrësin. Shuma e tillë do të jetë kredituar vetiu në çdo bankë dhe/ose ndryshimi i kuotave dhe/ose taksave dhe njoftimi për Mediocredito Centrale-n ose personat përgjegjës për kërkimin.

Neni 8
Lëshimi i Deklaratës së Borxhit

8.1. Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e skadimit të disbursimit të fundit të Kredisë Financiare, shprehur në nenin 5.1., Huamarrësi do t'i lëshojë Mediocredito Centrale-s një deklaratë për borxhin e sigluar në çdo faqe dhe të firmosur në formën e aneksit C.

8.2. Sa më sipër, përmendjes së Deklaratës së Borxhit do të jetë bërë transferimi nga Mediocredito Centrale me një person publik, ose privat italian ose person të huaj legal. Është e kuptueshme që Huamarrësi nuk do të jetë përgjegjës ose i prirur për çdo ndryshim, kuotizacion ose taksë që mund të jetë si rezultat i transferimit të Deklaratës së Borxhit Mediocredito Centrale do të njoftojë Bankën Agjente për transferimin e Deklaratës së Borxhit.

8.3. Plani i shlyerjes së shprehur në Deklaratën e Borxhit do të përpilohet duke mbledhur të gjitha kuotat e principalit dhe të interesave ende të pamaturuara në datën e lëshimit të Deklaratës së Borxhit, që rezultojnë nga çdo plan shlyerjeje, të kryera në fillin të çdo disbursimi sipas klauzolave të nenit 6.7.

8.4. Mediocredito Centrale do të depozitojë Deklaratën e Borxhit për ruajtje dhe administrim dhe kohë pas kohe do të regjistrojë në Deklaratën e Borxhit shumën për çdo pagesë të principalit dhe të interesit, sa më shpejt, për të gjitha pagesat e çdo shume të menduar në Deklaratën e Borxhit që do të jetë bërë do t'ia kthejë Huamarrësit, të firmosur dhe të vërtetuar.

Neni 9
Zotimet e Huamarrësit

9.1. Huamarrësi zotohet të paguajë shumat e detyrueshme në Konventën Financiare dhe Deklaratës së Borxhit të lidhur për më tepër është e pavarur, absolute, e pakushtëzuar dhe e pandryshueshme.

9.2. Nën çdo rrethanë, marrëveshja nuk do të jetë përdorur për pagimin e taksave, importeve të detyrueshme, tarifave ose VAT. Përveç kësaj, Qeveria e Republikës së Shqipërisë angazhohet të marrë çdo aksion të nevojshëm me largimin e tillë të nevojshëm përpara se kjo Marrëveshje Financiare të hyjë në fuqi.

Neni 10
Pezullimi i disbursimeve

10.1. Gjatë periudhës së disbursimit të Kredisë Financiare, Mediocredito Centrale rezervon të drejtën të pezullojë çdo kërkesë për disbursim sipas nenit 6, në kohë dhe në çdo vështirësi në lidhje me Mediocredito Centrale-n nën Konventën Financiare ose çdo konventë tjetër financiare të dhënë nga Mediocredito Centrale me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 6 të ligjit nr. 38 datë 9 shkurt 1979 dhe nenit 6 të ligjit nr. 49 datë 26 shkurt 1987 të Republikës së Italisë me amendamentet kohë pas kohe. Mediocredito Centrale do të informojë Huamarrësin për kohën e një pezullimi të tillë.

10.2. Mediocredito Centrale rezervon të drejtën të mos ekzekutojë asnjë kërkesë për disbursim, të kushtëzaur nga neni 6, në përputhje me shumat që nuk janë bërë të vlefshme nga Autoritete Kompetente Italiane.

Neni 11
Interesi i munguar

11.1. Në qoftë se Banka Tregtare Italiane, për çfarëdo arsye, qoftë edhe për arsye që nuk varen nga vullneti i Huamarrësit, nuk merr shumat e duhura për principalin dhe interesat brenda datave të caktuara, Huamarrësi është i detyruar t'i paguajë Bankës Agjente për shumat në fjalë, interesin e munguar, nga data e caktuar deri në datën aktuale të kreditimit, në favor të Mediocredito-s Centrale-s ose të personave të tjerë të emëruar.

11.2. Ky interes i munguar do të llogaritet me normën 0.20% (zero pikë njëzet për qind) për

periudhën e 35 (tridhjetë e pesë) ditëve, menjëherë pas datës fillestare të skadencës dhe me normë 5% (pesë për qind) deri në datën aktuale të kreditimit në favor të Mediocredito-s Centrale-s.

11.3. Për 35 (tridhjetë e pesë) ditët e para pas datës fillestare të skadimit, ky interes i munguar do të llogaritet duke përdorur formulën e thjeshtë të interesit; më pas, interesi i munguar do të llogaritet duke përdorur formulën e thjeshtë në qoftë se afati është më i shkurtër se një vit dhe formulën e përbërë të interesit në qoftë se afati kalon 1 vit.

Neni 12
Taksat

12.1. Subjekti i nenit 11.2. rreth çdo takse të tanishme ose të ardhme, të vendosur në Shqipëri, që do të ketë lidhje me këtë Konventë dhe me Deklaratën e Borxhit, do të jetë vetëm në ngarkim të Huamarrësit.

12.2. Mediocredito Centrale deklaron se do të përfitojë nga regjimi fiskal, nga neni 19 i dekretit të Presidentit të Republikës nr.601, datë 29 shtator 1973, i Republikës së Italisë bashkë me amendamentet kohë pas kohe.

Neni 13
Ligjet qeveritare

Marrëveshja Financiare do të jetë qeveritare dhe interpretohet në përputhje me ligjin italian.

Neni 14
Zgjidhja e marrëveshjeve

14.1. Palët do të përpiqen t'i zgjidhin miqësisht moskonventat që lindin nga interpretimi dhe ose ekzekutimi i kësaj Konvente.

14.2. Në qoftë se këto përpjekje nuk do të cenojnë në zgjidhjen e moskonventave brenda 90 ditëve (nëntëdhjetë), ato do të zgjidhen në nivel qeveritar.

14.3. Në qoftë se edhe kjo përpjekje do të dështojë, të gjitha moskonventat do të zgjidhen nga Arbitrazhi i Dhomës së Tregtisë Ndërkombëtare në Paris, Francë, nga një kolegj i përbërë nga tre anëtarë:

një i caktuar nga Huamarrësi;

një i caktuar nga Mediokredito Centrale;

tre arbitra të caktuar nga Arbitrazhi në fjalë ose, kur ata s'bien dakord, nga Presidenti i Dhomës së Tregtisë Ndërkombëtare në Paris.

14.4. Në qoftë se Huamarrësi ose Mediocredito Centrale nuk e caktojnë gjyqtarin e tyre brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga kërkesa e Palës tjetër, ky gjyqtar do të caktohet nga Kryetari i Dhomës së Tregtisë Ndërkombëtare në Paris.

14.5. Vendimi i Gjykatës që do të vendosë në përputhje me ligjin e Republikës së Italisë do të jetë detyrues dhe i pakushtëzuar për të dyja Palët, pa asnjë mundësi apelimi.

14.6. Çfarëdo mosmarrëveshje ose kontradiktë që do të lindë midis Palëve, nuk do të pezullojë detyrimet e Huamarrësit për të paguar në datat e caktuara të gjitha shumat në kuadrin e Konventës dhe në veçanti të gjitha shumat që rezultojnë në tabelat e shlyerjes, të shprehura në nenin 6 dhe në Deklaratën e Borxhit të lidhur me të.

Neni 15
Shënime

15.1. Shënimet në lidhje me Konventën do të adresohen si më poshtë:
Ministria e Financave - Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" – Tiranë – Shqipëri
Banka e Shqipërisë – Sheshi "Skënderbej" – Tiranë – Shqipëri
Mediocredito Centrale – Via Piemonte 51, 00187 Romë – Itali
Shërbimi i Strukturave Financiare: Zyra e marrëdhënieve financiare: tel: 003964791 2592/2749/2218, telefax n. 0039 64791 2574/2970

- Shërbimi Administrator: Zyrat Administratore e Strukturave Financiare: tel: 0039 64791 2380/2249/2516/2536/2206, telefax n.0039 64791 2059/2758;

Neni 16
Teksti origjinal i Konventës Financiare

16.1. Kjo Konventë është firmosur në italisht në katër origjinale dhe në anglisht në katër origjinale, në kopje autentike. Varianti i Konventës në gjuhën italiane do të jetë komandues në rast mosmarrëveshjeje.

NË EMËR TË QEVERISË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	NË EMËR TË MEDIOCREDITO CENTRALE
Prof. Dr. Kastriot Islami	
Ministër i Financave	
Firmosur në Tiranë më 6.6.2002	Firmosur në Romë më

(model për pagesën e parë të disbursimeve)
Aneksi A
Nga Huamarrësi
Për: MEDIOCREDITO CENTRALE

Marrëveshja Financiare për euro. 30,000,000 (tridhjetë milion), firmosur nga ne në Tiranë më ……dhe nga Mediocredito Centrale në Romë më ……

Në zbatim të nenit 6 të Konventës Financiare të mësipërme, ne ju kërkojmë që ju të vini në dispozicionin tonë, duke kredituar në "Llogarinë Speciale", hapur me Bankën e Shqipërisë, shumën në euro 10,000,000 (dhjetë milion), ku do të kreditohen fondet sipas termave të përcaktuara nga Autoritete Kompetente Qeveritare Italiane.

Në lidhje me këtë, gjendet njoftimi për përzgjedhjen e Kompanisë Audituese sipas procedurave të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Fondet e krediturara nga Mediocredito Centrale në këtë llogari, sipas nenit 6.2 të kësaj Konvente do të përdoren për financimin e programit për blerjen energjisë elektrike nga Italia.

Ne, në mënyrë të pakthyeshme dhe të pakushtëzuar, angazhohemi të shlyejmë çdo shumë në euro 10,000,000 (dhjetë milion) të kredituar nga ju në "Llogarinë Speciale" nr. 42 (dyzet e dy) këste të barabarta 6-mujore (kështet principale), ku i pari skadon 210 (dyqind e dhjetë) muaj nga data e blerjes efektive të Konventës Financiare të mësipërme.

Ne, gjithashtu, angazhohemi të paguajmë interesin e kontraktuar me normë vjetore nominale prej 0,20% (zero pikë njëzet qind), e barabartë me 0.10% (zero dhjetë për qind) 6-mujore, si dhe interesin e munguar, në përputhje me kushtet dhe konditat e vendosura në Konventën Financiare të mësipërme.

I juaji
(model disbursimet e dyta, të treta dhe të katërta)
Aneksi B
Nga: QEVERIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Për: MEDIOCREDITO CENTRALE
Marrëveshja Financiare për euro 30.000.000 (tridhjetë milion), firmosur nga ne në Tiranë më datë ……dhe nga Mediocredito Centrale në Romë më datë……

Në zbatim të nenit 6 të Konventës Financiare të mësipërme, ne ju kërkojmë që ju të vini në dispozicionin tonë, duke kredituar në "Llogarinë Speciale të ……" të hapur me Bankën e Shqipërisë për shumën në euro 20,000,000 (njëzet milion) ku do të kreditohen fondet sipas termave të përcaktuara nga Autoritetet Kompetente Qeveritare Italiane.

Në lidhje me këtë, ju lutemi të bashkëngjisni raportin e auditimit që përmban të gjithë

dokumentacionin e nevojshëm.

Fondet e krediturara nga Mediocredito Centrale në këtë llogari, sipas nenit 6.3. të kësaj Konvente do të përdoren për financimin e programit për blerjen e energjisë elektrike nga Italia.

Në mënyrë të pakthyeshme dhe të pakushtëzuar, angazhohemi të shlyejmë çdo shumë në euro 20,000,000 (njëzet milion) të kredituar nga ju në "Llogarinë Speciale" nr. 36 (tridhjetë e gjashtë) këste të barabarta 6-mujore (kështet principale), ku i pari skadon 222 (dyqind e njëzet e dy) muaj nga data e bërjes efektive të Konventës Financiare të mësipërme.

Ne, gjithashtu, angazhohemi të paguajmë interesin e kontraktuar me normë vjetore nominale prej 0.20% (zero pikë njëzet qind) e barabartë me 0.10% (zero dhjetë për qind) 6-mujore, si dhe interesin e munguar, në përputhje me kushtet dhe konditat e vendosura në Konventën Financiare të mësipërme.

Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e skadimit të disbursimit të fondit financiar, ne angazhohemi t'i dërgojmë Mediocredito Centrales një deklaratë të borxhit mbi shumën kryesore, që i korrespondon shumës në euro 30,000,000 (tridhjetë milion).

Kjo Deklaratë e Borxhit do të jetë në formën e aneksit C të Konventës Financiare të lartpërmendur.

I juaji

(model i njohjes së borxhit)

Aneksi C

QEVERIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nr.……

Vendi dhe data e lëshimit: ……

Në bazë të Konventës Financiare midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë – Ministrisë së Financave (sa më sipër Huamarrësi) dhe Mediocredito Centrales, firmosur në Tiranë, më ……dhe në Romë më datë ……, Huamarrësi deklaron të ketë marrë nga Medicredito Centrale, shumat e mëposhtme:

euro ……më ……

euro ……më……

Kështu, Huamarrësi deklaron, në mënyrë të pakushtëzuar dhe të pakthyeshme, të jetë debitore e Mediocredito Centrale me zyrë të regjistruar në Romë-Itali, rruga Piemonte 51, për shumën principale prej euro …… (……) dhe angazhohet të shlyejë në 36 (tridhjetë e gjashtë) këste të barabarta 6-mujore, konsekutive, ku i pari duhet të paguhet më …… dhe i fundit më……sipas afatit të shlyerjes së vendosur më poshtë.

Për shumën principale të detyruar, në këtë njohje të Borxhit, Qeveria e Republikës së Shqipërisë angazhohet të paguajë interesat që i referohen afatit të shlyerjes të shprehura më poshtë, të kalkuluara në përputhje me klauzolat e Konventës Financiare të lartpërmendur.

Huamarrësi do të shlyejë këstet principale dhe do të paguajë interesat e përcaktuara në Deklaratën e Borxhit, duke kredituar shumat në euro, në datat e caktuara, në favor të Mediocredito Centrale ose personave të emëruar, nëpërmjet degës së zyrës (Romë)……pa komisionet bankare.

Në qoftë se dega zyrë (Romë) e……, për çfarëdolloj arsye, duke përfshirë edhe ata që janë jashtë kontrollit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, nuk merr shumat që i detyrohen për principalin dhe interesat në përputhje me këtë Deklaratë të Borxhit brenda datave të caktuara, Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të jetë e detyruar t'i paguajë për shumat në fjalë degës së Romës të Institutit Bankar San Paolo Torino, interesin e munguar nga data e caktuar deri në datën e kreditimit në favor të Mediocredito Centrale ose të personelit tjetër të emëruar.

Interesi i munguar në fjalë do të kalkulohet në normën 0.20% (zero pikë njëzet për qind) për periudhën e 35 (tridhjetë e pesë) ditëve pas datës së caktuar dhe me normën 5% (pesë për qind) deri në ditën e kreditimit në favor të Mediocredito Centrale.

Për 35 (tridhjetë e pesë) ditët pas ditës së caktuar, ky interes i munguar do të llogaritet duke përdorur formulën e thjeshtë të interesit, në qoftë se afati është më i shkurtër se një vit dhe duke përdorur formulën e përbërë, në qoftë se afati kalon një vit.

Aneksi C (në vazhdim)

Dega e zyrës në (Romë)…… herë pas here, do të shënojë në këtë Deklaratë të Borxhit

çdo pagesë të principalit dhe interesit.

Menjëherë, sapo pagesa e listës të rradhitura në tabelën e shlyerjes më poshtë do të jetë kryer, kjo Deklaratë e Borxhit do t'i rikthehet Bankës ……

Kjo Deklaratë e Borxhit lëshohet në lidhje me Kredinë Financiare prej euro 30,000.000. (tridhjetë milion), dhënë konform nenit 6 të ligjit nr. 49, datë 26 shkurt 1987 të Republikës së Italisë.

TABELA E SHLYERJEVE

Data e maturimitKëstet e principalitKëstet e interesaveTotali

a.……

b. ……

c. ……

d. ……

1. ……

2. ……

3. ……

4.……

5. ……

6. ……

7. ……

8. ……

9. ……

10. ……

(firmosur nga Huamarrësi)